

# Dialogu Kosovë-Serbi i ndërmjetësuar nga BE: Një tentativë e re apo rifillim me qasje të vjetër?

---



**Ky projekt është i mbështetur nga: Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)**

**Autore: Jeta Krasniqi**

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI) dhe Fondacioni Konrad Adenauer.

Instituti Demokratik i Kosovës dhe Fondacioni Konrad Adenauer i kanë të gjitha të drejtat e rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin domosdo qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

# Përmbajtja

---

<b>HYRJE</b>	<b>4</b>
<b>PROJEKTIMI I DIALOGUT KOSOVË-SERBI</b>	<b>5</b>
<b>POLITIKA E PËRBASHKËT E JASHTME DHE E SIGURISË SË BE-SË: TRAKTATI I LISBONËS</b>	<b>7</b>
<b>PROJEKTIMI I ROLIT TË BE-SË SI NDËRMJETËSUES I DIALOGUT KOSOVË-SERBI</b>	<b>9</b>
<b>EPOKA E ASHTON</b>	<b>10</b>
<b>TRASHËGIMIA ASHTON</b>	<b>12</b>
<b>LIMITET E METODËS SË NDËRMJETËSIMIT TË ASHTON SI PËRFAQËSUESE E LARTË E BE-SË</b>	<b>13</b>
<b>NGA SUKSESI DREJT KRITIKAVE: PËRFAQËSUESJA E LARTË ZNJ. MOGHERINI</b>	<b>14</b>
<b>TRASHËGIMIA E MOGHERINIT</b>	<b>17</b>
<b>PËRFAQËSUESI I LARTË DHE SHËRBIMI EVROPIAN PËR VEPRIM TË JASHTËM, NË ROL DYTËSOR?</b>	<b>19</b>
<b>MANTRA E VJETËR NGA ZYRTARËT E RINJ “DIVERSITET RRETH NJOHJES, POR UNITET NË ANGAZHIM”</b>	<b>20</b>
<b>SPANJOLLI BORRELL PËRFAQËSUES I LARTË I POLITIKËS SË JASHTME DHE TË SIGURISË SË BE-SË</b>	<b>19</b>
<b>EMËRIMI I LAJÇAK</b>	<b>22</b>
<b>DYZIMI I ROLIT TË BE-SË DHE SHBA-VE</b>	<b>24</b>
<b>KONKLUZIONE</b>	<b>25</b>
<b>REKOMANDIME</b>	<b>27</b>

## HYRJE

Më 17 shkurt 2008, Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran. Përpjekjet disa vjeçare, të udhëhequra nga ish Presidenti finlandez Martti Ahtisaari, për një marrëveshjeje të pranuar nga Kosova dhe Serbia kishin dështuar, për shkak të refuzimit të palës serbe për të pranuar planin që mori emrin e diplomatit të rryer finlandez. Ngjashëm dështuan dhe përpjekjet e 'Troika'-së<sup>1</sup>, të cilat vetëm nxorën në pah qëndrimin e kundërt të palëve kundrejt shpalljes së pavarësisë të Kosovës. Realiteti i krijuar në Kosovë që nga periudha e përfundimit të konfliktit dhe vendosjes së misionit të UNMIK-ut kërkonte zgjidhjen e statusit të saj, i cili nuk kishte alternativë tjetër përveç se shpalljes së pavarësisë. Kjo do të nënkuptonte nevojën për përcaktimin e mëtejme të marrëdhënieve të shtetit të ri me Serbinë, gjë që u vërtetua shumë shpejt.

Me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, pritej që Kosova do mund të ushtronte funksionet e saja si shtet i barabartë me shtetet e tjera. Në realitet, rrugëtimi drejt funksionalizimit të plotë të shtetësisë së saj, mbetet ende i papërfunduar. Prania e Serbisë, UNMIK-ut dhe BE-së, vazhdoi të mbetej e njëjtë duke krijuar kështu një rrjet të institucioneve me juridiksione të mbivendosura. Funksionimi i një pjese të tyre ndërli dhe me pavarësinë e mbikëqyrur, ndërsa institucionet paralele të financuara nga Serbia ishin dhe mbeten cenim i ushtrimit të sovranitetit të brendshëm, duke krijuar realitete paralele të funksionimit politik, juridike e shoqëror brenda shtetit të Kosovës.<sup>2</sup> Paralajmërimi i Ruisë dhe Kinës se do të përdornin fuqinë e vetos, i pamundësoi Kosovës anëtarësimin në OKB, duke e shtyrë shtetin e ri dhe miqtë e saj ndërkombëtar, drejt fushatave lobuese për njohje individuale nga shtete të ndryshme të botës si rrugë drejt konsolidimit të saj ndërkombëtar. Ndërsa, se

çështjet e mbetura të hapura në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të zgjidheshin me një tjetër proces të dialogut, u bë evidente në një Rezolutë të re të OKB-së (shtator 2010) e cila i dha ndërmjetësimin e këtij procesi BE-së. Ky proces shënoi sukseset dhe dështimet e tij duke rrugëtuar në kompleksitetin e vendimmarrjes brenda BE-së, nën paqartësinë e objektivave të këtij procesi apo dhe të vet epilogut të pritshëm të tij.

Ky punim ka për qëllim të analizojë procesin e ndërmjetësimi të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë nga BE-së, nëpërmjet politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, duke vënë në pah përparësitë dhe limitet e qasjes së përdorur nga Përfaqësuesit e Lartë të BE-së. Në radhë të parë, duke kuptuar kompetencat e Përfaqësuesit të Lartë, sipas Traktatit të Lisbonës mbi të cilin ndërtohet analiza e trashëgimive të dy mandateve të 'ministre të jashtme' të BE-së në fazat e ndryshme të këtij procesi, limitet e qasjes së ndërmjetësimi nga BE, ku adresohet dhe roli i shteteve anëtare veçanërisht roli i Gjermanisë dhe Francës. Punimi adreson gjithashtu bashkëpunimin e BE-së me SHBA-të në kuadër të këtij procesi duke nxjerr në pah dhe zhvillimet e fundit rreth qasjes amerikane. Mbi bazën e analizës punimi ofron një sërë rekomandimesh për fazën aktuale kur tashmë BE ka emëruar një të dërguar të posaçëm për çështjen e dialogut Kosovë-Serbi dhe çështjeve të tjera të Ballkanit Perëndimor duke nënvizuar nevojën e një mbështetjeje më të madhe të këtij procesi nga ana e shteteve anëtare, pozicionimin më të qartë të BE-së në kuadër të procesit që shkon përtej rolit neutral dhe të ofruesit të 'tryezës së vullnetit të mirë' por që në realitet lidh procesin me ofrimin e perspektivës evropiane të Kosovës. E gjithë kjo nën rolin e shtuar të SHBA-ve dhe nevojën e bashkërendimit të faktorit ndërkombëtar për ecjen tutje të procesit.

1 Frank Wisner përfaqësues i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Alexandar Botsan-Kharchenko përfaqësues i Ruisë and Wolfgang Ischinger përfaqësues për BE-në.

2 Krasniqi, G. & Musaj, M. (2014). *The EU's 'limited sovereignty-strong control/approach in the process of Member State building in Kosovo*. London: Routledge. Fq. 140-162

# Projektimi i dialogut Kosovë-Serbi

Përprojekjet e Serbisë për të sabotuar shtetin e Kosovës nuk reshtën me shpalljen e pavarësisë së saj. Ndonëse Beogradi zyrtar, nën udhëheqjen e Boris Tadiq, kishte filluar të orientonte politikën e saj drejt BE-së, ministri i jashtëm i Serbisë Vuk Jeremiq mbeti i përkushtuar për të minuar konsolidimin ndërkombëtar të Kosovës.<sup>3</sup> Serbia arriti të shtynte përpara në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara kërkesën për mendim këshilldhënës të GjND-në për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Më 2010, GjND-ja, bëri publik mendimin e saj këshilldhënës, duke konkluduar që akti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk kishte shkelur normat ndërkombëtare dhe ishte në përputhje me Rezolutën 1244. Pavarësisht se u cilësua si fitore nga pala kosovare, ky veprim megjithatë solli një proces të ri të dialogut.

Në ditën e publikimit të opinionit të GjND-së, Përfaqësuesja e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Baronessa Catherine Ashton, mirëpriti aktgjykimin në një deklaratë ku, mes tjerash, thuhej: *“Mendimi këshilldhënës i GjND-së hap një fazë të re. E ardhmja e Serbisë është në BE. E ardhmja e Kosovës është në BE. Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimi rajonal dhe dialogu janë themelet mbi të cilat është ndërtuar BE. [...] Bashkimi Evropian është i gatshëm të ndërmjetësojë një proces të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit”,* duke mos përmendur pesë shtetet mosnjohëse.<sup>4</sup> Por, kjo deklaratë u injorua nga Serbia, e cila më 28 korrik dorëzoi një draft-rezolutë tjetër në OKB me të cilin kërkoi negociata të reja për statusin e

Kosovës.<sup>5</sup> Me insistimin e drejtpërdrejtë të Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë për të ndryshuar draft-rezolutën<sup>6</sup>, si dhe përfshirjes së Përfaqësueses së Lartë të BE-së, Catherine Ashton, u arrit kompromis i përbashkët për një tekst të ri të kësaj rezolute. Rezoluta e re, e cila parashihte fillimin e procesit të dialogut Kosovë-Serbi, të ndërmjetësuar nga BE-ja, u miratua në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së më 9 shtator 2010.<sup>7</sup>

Robert Cooper, ish negociatori i dialogut teknik Kosovë-Serbi, në një opinion të tij të vitit 2015 hedh pak dritë në prapaskenat e diskutimeve rreth Rezolutës së Kombeve të Bashkuara. Ai lë të kuptohet që ky frazim ishte produkt i kompromiseve në dy takimet e Komisionit të BE-së për Siguri dhe Politikë<sup>8</sup>, ku siç shprehet ai: *“idetë më ambicioze ranë në ujë duke konsideruar faktin që Kosova nuk njihet nga pesë shtete të BE-së”*.<sup>9</sup>

3 Van der Borgh, Ch. & Le Roy, P. & Zweerink, F. (2018), “EU peacebuilding capabilities in Kosovo after 2008: an analysis of EULEX and the EU-facilitated Belgrade-Pristina Dialogue”, *Center for Conflict Studies, Utrecht University*, Fq.41

4 Deklarata nga Përfaqësuesja e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, në emër të Bashkimit Evropian për Mendimin Këshilldhënës të GjND-së (22 Korrik, 2010). E qasshme në: [https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/foraff/115902.pdf](https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/115902.pdf)

5 Economides, S. & Ker-Lindsay, J. (2015). ‘Pre-Accession Europeanization’: The Case of Serbia and Kosovo. *JCMS: Journal of Common Market Studies*. 53. Fq.41

6 Ministri i Jashtëm i Gjermanisë Guido Westerwelle dhe FCO William Hague kishin vizituar Beogradin për të diskutuar rreth ndryshimit të tekstit të Rezolutës.

7 Kompromisi i Serbisë u përkthye në shpërbllim nga ana e BE-së ku Këshilli i kërkoi Komisionit të jepte opinionin e saj për aplikimin e Serbisë për anëtarësim. I fundit konstatoi se Këshilli duhet t'i ofronte statusin e vendit kandidatë dhe të hapte negociatat me Serbinë lidhur me përkushtimin e kësaj të fundit në procesin e normalizimit me Kosovën.

8 Në përbërje të diplomatëve të shteteve të BE-së, përfaqësuesve të Komisionit Evropian dhe përfaqësueses së lartë për politikë të jashtme dhe siguri znj. Catherine Ashton.

9 Cooper, R. (2015). Opinion – “The Philosophy of the Belgrade-Pristina Dialogue”. I qasshëm në: <https://european-westernbalkans.com/2015/07/16/sir-robert-cooper-the-philosophy-of-the-belgrade-pristina-dialogue/>



Mendimi këshillëdhënës i **GJND-së** hap një fazë të re. E ardhmja e **Serbisë** është në **BE**. E ardhmja e **Kosovës** është në **BE**. Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimi rajonal dhe dialogu janë themelet mbi të cilat është ndërtuar **BE**. [...] Bashkimi Evropian është i gatshëm të ndërmjetësojë një proces të dialogut ndërmjet **Prishtinës** dhe **Beogradit**”

Gjithsesi, Rezoluta në terminologjinë e saj nuk vë në pah ndryshimet e raporteve të BE-së me këto dy shtete, duke i cilësuar ato si palë, siç nuk ofron mjaftueshëm qartësi për qëllimet e këtij procesi apo dhe epilogun e pritshëm të tij. Por vetë fakti që kjo Rezolutë u sponsorizua nga 28 shtetet anëtare të BE-së dhe Serbia, por jo edhe nga Kosova – si jo anëtare e OKB-së, nxori në pah esencën e problematikës në mes të Kosovës dhe Serbisë – qëndrimet e ndryshme të tyre rreth shtetësisë së Kosovës.

Rezoluta i jepte një rol të ri BE-së në paqebërje në Ballkanin Perëndimor, duke ndërlidhur këtë proces me perspektivën evropiane të palëve, bashkëpunimin e ndërsjellë dhe përmirësimin të jetës së qytetarëve.<sup>10</sup> Por, ndërsa BE-ja morri përsipër këtë rol, në takimin pasues të Këshillit Evropian, si mekanizmi më i lartë vendimmarrës i BE-së, çështja e rolit ndërmjetësues të BE-së apo dhe vendimi i GJND-së nuk u bë pjesë e konkluzave të saj.<sup>11</sup>

10 Doli D. (2019). *Brussels Agreement: Between Statehood and 1244 Status*. Në: *The International Element, Statehood and Democratic Nation-building*. Cham, Springer. Fq. 159-179.

11 Viceré, A. G. M. (2016). The roles of the President of the European Council and the High Representative in leading EU foreign policy on Kosovo. *Journal of European Integration*, 38:5. Fq. 562.

# Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë së BE-së: Traktati i Lisbonës

Që në fund të viteve të 90-ta, BE-ja filloi të projektonte ambiciet e saja në arenën ndërkombëtare, duke synuar institucionalizimin e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë. Në kuadër të saj, synohej edhe hapja e një kapitulli të ri të angazhimit me Ballkanit Perëndimor. Në fakt, BE-ja kishte qenë aktive në rajon dhe më parë, sidomos gjatë periudhës së shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ku ishte argumentuar që nuk kishte arritur të ishte e suksesshme ndër të tjera për shkak të mungesës së përvojës, unitetit të brendshëm si dhe mungesës së instrumenteve që kishte në dispozicion për të operuar.<sup>12</sup>

Me Traktatin e Lisbonës<sup>13</sup> i jepet formë politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së Bashkimit Evropian, ku shënohet një forcim i rolit të forumeve ndërqeveritare për koordinim të politikave dhe vendimmarrjes së përbashkët. Traktati përcaktoi që Këshilli Evropian është *“burimi kryesor udhëheqës në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë”*, i cili ka për mandat gjithashtu të mbikëqyrë dhe monitorojë edhe forumet e tjera ndërqeveritare siç është në këtë rast dhe Këshilli për Punë të Jashtme. Siç kishte deklaruar dhe Presidenti i atëhershëm i Këshillit Evropian, Van Rompuy: *“Mesazhet kryesore menaxhohen nga Këshilli i Evropës. Ato duhet të përgatiten dhe zbatohen nga Komisioni dhe Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri”*.<sup>14</sup> Në të njëjtën kohë, Traktati themelon dhe pozitën e Përfaqësuesit të Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë (Përfaqësuesi

i Lartë) i veshur me rolin e përpiluesit të propozimeve për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë si dhe zbatuesit të vendimeve dhe kursit të politikave të përcaktuara nga Këshilli Evropian dhe Këshilli.<sup>15</sup> Përfaqësuesi i Lartë merr pjesë në takimet e Këshillit Evropian, ushtron rolin e Nënkrjetarit të Komisionit Evropian, si dhe udhëheqë për mandat pesë vjeçar Këshillin për Punë të Jashtme (FAC).<sup>16</sup> Por, Traktati përcakton qartazi që, kur shtetet anëtare nuk kanë një pozicion të përbashkët apo nuk kanë arritur kompromis për një politikë, Përfaqësuesi i Lartë nuk mund të mbajë qëndrim mbi çështjen në fjalë.<sup>18</sup>

Traktati i jep personalitet ligjor BE-së por jo dhe të drejtën e kësaj të fundit për të njohur shtete, kompetencë e cila vazhdon t’iu mbetet shteteve anëtare.<sup>19</sup> Për shkak të karakteristikës institucionale, pozicioni i Përfaqësuesit të Lartë konsiderohet të jetë në udhëkryq në mes sferës supranacionale dhe ndërqeveritare të BE-së<sup>20</sup>, rol ky i cili nuk mund të tejkalojë vendimmarrjen e Këshillit. Me anë të Traktatit shohim gjithashtu dhe formimin e

12 Bieber, F. (2015). The Serbia-Kosovo Agreements. *Review of Central and East European Law*, 40. Fq. 291.

13 Politika e Përbashkët për Punë të Jashtme dhe Siguri (CFSP) e Bashkimit Evropian është rregulluar me Traktatin e Maastricht-it në vitin 1992, më pas me Traktatin e Amsterdamin më 1997 me anë të së cilës themelohet zyra e Përfaqësuesit të Lartë për CFSP, roli i të cilit ka qenë që të koordinojë politikën e jashtme të BE-së dhe çështjet në lidhje me Presidencën me rotacion; të flas në emër të BE-së për çështjet e caktuara për politikë të jashtme.

14 Konkluzat e Këshillit Evropian, të vitit 2010. Të qasshme në: <https://www.consilium.europa.eu/media/21369/qc3010507enc.pdf>

15 Viceré, A. G. M. (2016). The roles of the President of the European Council and the High Representative in leading EU foreign policy on Kosovo. *Journal of European Integration*, 38:5. Fq. 559.

16 FAC ka funksione legjislativ dhe ekzekutive në fushën e CFSP dhe CSDP si instrumenti operacional i politikës së jashtme dhe të sigurisë duke pasur të drejtën për të vendosur për ‘veprime të përbashkëta’ dhe ‘qëndrime të përbashkëta’.

17 Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri në kuadër të mandatit të tij/saj shërben dhe si urë në mes të Komisionit dhe Këshillit për politikë të jashtme në kuadër të së cilës synon koordinimin e politikave dhe ndërtimin e konsistencës në mes të Komisionit dhe FAC.

18 Viceré, A. G. M. (2018). *The High Representative and EU Foreign Policy Integration – A Comparative Study of Kosovo and Ukraine*. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 83.

19 Dessus, Z., Rexha, A., Merja, A. & Stratulat C. (2017). Discussion Paper – “Kosovo’s EU candidate status: a goal within reach?”. European Policy Center & Group for Legal and Political Studies. Fq. 5.

20 Viceré, A. G. M. (2018). *The High Representative and EU Foreign Policy Integration – A Comparative Study of Kosovo and Ukraine*. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 10.



## Themelimi i zyrës së Përfaqësuesit të Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe Shërbimet e Jashtme, nuk ndikojnë në përgjegjësit e shteteve të **BE-së** në formulimin dhe ushtrimin e politikës së jashtme apo dhe përfaqësimin e tyre në shtete të treta dhe organizata ndërkombëtare

Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS)<sup>21</sup>, një 'quasi-ministri e jashtme dhe korpus diplomatik', një organizëm hibrid në mes shteteve anëtare dhe institucioneve të tjera të BE-së<sup>22</sup>, që ka për mision ofrimin e mbështetjes për Përfaqësuesin e Lartë në zbatimin e rolit të tij/saj.<sup>23</sup>

*"[...] Themelimi i zyrës së Përfaqësuesit të Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe Shërbimet e Jashtme, nuk ndikojnë në përgjegjësit e shteteve të BE-së në formulimin dhe ushtrimin e politikës së jashtme apo dhe përfaqësimin e tyre në shtete të treta dhe organizata ndërkombëtare".<sup>25</sup>*

Politika e përbashkët e jashtme dhe sigurisë së BE-së sipas Wessel dhe den Hertog (2012), është cilësuar dhe si kompetencë *sui generis*, ndërsa Blanke dhe Mangjameli 2012<sup>24</sup> e konsiderojnë atë si një dëshirë politike e shteteve për të parandaluar 'komunitarizimin' e qeverisjes së politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, si dhe politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes, pasi që dhe në vet Traktatit e Lisbonës është qartë e thënë:

21 EEAS përbëhet nga staf profesional i transferuar nga Këshilli, shtetet anëtare dhe Komisioni Evropian. Qëllimi i së cilës është të fuqizoj përkushtimin e shteteve anëtare të BE-së për integrim më të madh të BE-së në fushën e politikës së jashtme.

22 Ćuković, K. (2019). Europe's diplomacy on public display: The EU and the Belgrade-Pristina dialogue – Event analysis. *Contemporary Southeastern Europe*, 6 (1). Fq. 3.

23 Për më shumë, shih nenin 27 të Traktatit të Bashkimit Evropian, i njohur ndryshe si Traktati i Lisbonës. I qasshëm në: [https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:2b-f140bf-a3f8-4ab2-b506-fd71826e6da6.0023.02/DOC\\_1&format=PDF](https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:2b-f140bf-a3f8-4ab2-b506-fd71826e6da6.0023.02/DOC_1&format=PDF)

24 Viceré, A. G. M. (2018). *The High Representative and EU Foreign Policy Integration – A Comparative Study of Kosovo and Ukraine*. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 87.

25 Po aty, Fq. 83



# Projektimi i rolit të BE-së si ndërmjetësues i dialogut Kosovë-Serbi

Me Traktatin e Lisbonës, Ballkani Perëndimor bëhet tashmë pjesë e agjendës së rregullt të Këshillit Evropian<sup>26</sup> në kuadër të së cilës BE e sheh transformimin e këtij rajoni nën prizmin e instrumenteve transformuese të agjendës së zgjerimit. Ky angazhim erdhi si nevojë e orientimit gjeopolitik si dhe si rezultat i presioneve të brendshme dhe të jashtme, siç ishin ato nga SHBA-të, që e konsideruan tashmë Ballkanin Perëndimor si përgjegjësi të BE-së.<sup>27</sup> Kjo e fundit materializohet dhe nën rolin e ndërmjetësuesit të konflikteve, në kontekstin e dialogut Kosovë-Serbi, i cili u konsiderua si test i diplomacisë së BE-së dhe aftësive të saja për të zgjidhur konflikte rajonale.<sup>28</sup> Duke ditur që pesë shtete anëtare të BE-së nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, u konsiderua që BE-ja arriti të operojë në mënyrë të integruar. Duke tejkaluar diferencat, BE-ja arriti të dakordohet për të ndërmjetësuar procesin e dialogut Kosovë-Serbi dhe të ndërlidhë rrugëtimin evropian të palëve me procesin e normalizimit si një platformë e përbashkët për ta.

Ky portofolio i politikave të BE-së u konsiderua si shembull i ndërlidhjes së politikës së përbashkët ndërqeveritare për politikë të jashtme dhe siguri, si dhe e politikave supranacionale të zgjerimit.<sup>29</sup> Kjo e fundit do të nënkuptonte që Presidenti i Këshillit Evropian së bashku me Përfaqësuesen e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, në ushtrimin e funksioneve të tyre duhet të ruanin konsistencën e diplomacisë bilaterale të BE-së në marrëdhënie me qeveritë e shteteve të Ballkanit Perëndimor.<sup>30</sup> Në rastin e Kosovës do të lexohej në formën që BE-ja ka një qëndrim neutral ndaj shtetit të Kosovës, pozicion i cili u synua të ruhej edhe përgjatë procesit të ndërmjetësimit të negociatave Kosovë-Serbi.

26 Për më shumë, shih Udhëzimet e European Council in Action për Parlamentin Evropian. Të qasshme në: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/615678/EPRS\\_BRI\(2018\)615678\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/615678/EPRS_BRI(2018)615678_EN.pdf)

27 Viceré, A. G. M. (2018). *The High Representative and EU Foreign Policy Integration – A Comparative Study of Kosovo and Ukraine*. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 108.

28 Krasniqi, G. & Musaj, M. (2014). *The EU's 'limited sovereignty'-strong control/approach in the process of Member State building in Kosovo*. London: Routledge. Fq. 140-162

29 Viceré, A. G. M. (2016). The roles of the President of the European Council and the High Representative in leading EU foreign policy on Kosovo. *Journal of European Integration*, 38:5. Fq. 558.

30 Po aty, Fq. 562.

## Epoka e Ashton

Në vitin 2011, nën ndërmjetësimin e BE-së, filloi faza e parë e dialogut, që u etiketua si një proces teknik. Deri më Maj 2012, sa zgjati dhe kjo fazë, palët mbajtën nëntë takime në kuadër të së cilave u arritën shtatë marrëveshje të cilat u cilësuan si teknike por që në thelb të tyre kishin në fakt relatat politike në mes të dy shteteve.<sup>31</sup> Limitet e kësaj faze u vunë në pah shumë shpejt, duke konsideruar vet pozicionet e palëve ndaj statusit të Kosovës në një kohë kur raportet në mes tyre vazhduan të mbesin të acaruar, duke e bërë më se evidente që dialogu duhej të zhvillohej në nivel politik.

Më 2012, filloi faza e dytë e dialogut, e cila u njoh si dialog politik që u zhvillua në nivel të Kryeministrave dhe nën ndërmjetësimin e drejtpërdrejtë të Përfaqësues së Lartë, Catherine Ashton. Kjo e fundit kishte besuar që gjithsesi palët kishin arritur të ndërtonin një besim në mes tyre dhe mund të diskutonin për çështje të cilat ishin më të ndjeshme. Pavarësisht se Ashton kishte ndarë me palët një plan për bisedime, i njëjti nuk ishte pranuar apo bërë publik. Ndërsa, nuk ishin të rralla raportet që argumentonin që nëse palët donin të arrinin progres atëherë duhej të diskutonin për çështjet të cilat kishin të bënin me veriun e Kosovës,<sup>32</sup> pavarësisht deklaratave të liderëve të Kosovës të cilën insistonin publikisht që çështjet e brendshme të Kosovës nuk do të ishin pjesë e këtyre diskutimeve.

Pas dhjetë takimesh, më 19 prill të vitit 2013, palët arritën Marrëveshjen e Parë të Normalizimit të Raporteve, nën ndërmjetësimin e Përfaqësueses së Lartë dhe me asistencë të EEAS-së, marrëveshje kjo e cila në pjesë të madhe të saj adreson çështje të brendshme të Kosovës.

Me këtë marrëveshje, BE-ja shënoi fitoren e parë të diplomacisë së saj duke i ofruar dhe vlerën e shtuar EEAS-së si aktor i ri i politikës së jashtme të BE-së.<sup>33</sup> Në raportet e BE-së, nënshkrimi i kësaj marrëveshje u cilësua si një ndër arritjet më të rëndësishme të BE-së në marrëdhëniet e jashtme.<sup>34</sup> Mesazhe përshëndetëse dhe inkurajuese për palët u formuluan dhe nga Presidenti i Këshillit të Evropës, Van Rompuy, i cili shprehu mirënjohje për rolin e Ashton në këtë proces dhe kurajon e dy liderëve për arritjen e saj. Stefan Lehne, një ish zyrtar i lartë i BE-së, shkroi katër ditë më pas se: *"Marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë dëshmon se diplomacia e mençur së bashkë me fuqinë që mbart perspektiva për zgjerim evropian, mund ende të sjell/prodhojë rezultate domethënëse"*.<sup>35</sup>

31 Në këtë fazë pala kosovare u përfaqësua nga Zëvendës Kryeministria Edita Tahiri, Serbia nga Borko Stefanović drejtor politik në Ministrin e Punëve të Jashtme të Serbisë, ndërkohë që procesi u ndërmjetësua nga Robert Cooper nën mbikqyrjen e Përfaqësueses së Lartë

32 Bergmann, J. (2020). *The European Union as International Mediator Brokering Stability and Peace in the Neighbourhood*. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 126.

33 Blockmans, S. (2013). Opinion – "Kosovo-Serbia deal shows value of EU diplomatic service". I qasshëm në: <https://euobserver.com/opinion/119903>

34 Doli D. (2019). *Brussels Agreement: Between Statehood and 1244 Status*. Në: The International Element, Statehood and Democratic Nation-building. Cham: Springer. Fq. 159.

35 Lehne, S. (2013). Article – "Serbia-Kosovo Deal Should Boost the EU's Western Balkans Policy". I qasshëm në: <https://carnegieeurope.eu/2013/04/23/serbia-kosovo-agreement-should-reenergize-eu-s-western-balkans-policy/g0q8#>



Marrëveshja në mes të **Kosovës** dhe **Serbisë** dëshmon se diplomacia e mençur së bashkë me fuqinë që mbart perspektiva për zgjerim **evropian**, mund ende të sjell/prodhojë rezultate domethënëse.

Palët shpallën fitoret e kampeve të tyre, ku Thaçi deklaroi se Serbia kishte njohur “*de facto*” shtetin e Kosovës, ndërsa Daçiq të kundërtën, duke nxjerrë në pah esencën e kontestit në mes tyre që nuk u tejkalua me këtë marrëveshje. Marrëveshja e prillit u konsiderua dhe “si aranzhim për ndarjen e pushtetit në veri të Kosovës në mes të autoriteteve të cilat janë të pranueshme për të dyja palët.”<sup>36</sup> Në një njëjtë frymë mund të lexohet dhe vet deklarata e Cooper i cili ishte shprehur se synimi i vet dialogut nuk ishte ndërrimi i gjendjes në terren, por kthimi i këtij realiteti në sistem ligjor. Lehne argumentoi që në qendër të bisedimeve ishte balanci në mes të kërkesave të të dyja palëve duke i quajtur ato si kërkesa legjitime, ku në njërin anë, serbët e Kosovës do të siguroheshin që do të vazhdonin të jetonin në stilin e jetës së tyre dhe do të vazhdonin lidhjen me Serbinë, ndërsa Kosovës i duhej që Serbia të pranonte që veriu është dhe do të qëndroj pjesë e Kosovës.<sup>37</sup>

Në të vërtetë, marrëveshja arriti të ofronte vetëm zgjidhje të pjesshme për një pjesë të çështjeve në mes palëve të cilat ende kanë mbetur pezull. Ndërsa shënoi një kthesë politike në raportet në mes palëve, duke e pozicionuar vet BE-në si lojtar kyç në promovimin e paqes dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

36 Po aty.

37 Po aty.

## Trashëgimia Ashton

Pas arritjes së Marrëveshjes së Prillit palët mbajtën dhe një numër takimesh të tjera të cilat u fokusuan në zbatimin e marrëveshjeve. Transparenca për formën e organizimit të takimeve apo personave të përfshirë në këtë proces nuk përbën pikën më të fortë të saj. BE-ja insistoi se roli i saj ishte vetëm lehtësuese e procesit, ku zyrtarë të EEAS-së dhe Komisionit Evropian kishin qenë pjesë e këtyre takimeve duke i udhëhequr të njëjtat në nivel teknik varësisht nga temat e diskutimit. Por nuk munguan as rastet kur zyrtarë të BE-së propozuan zgjidhje dhe draftuan marrëveshje, siç kishte qenë rasti i marrëveshjes së telekomunikacionit apo dhe aranzhime të tjera.<sup>38</sup> Pavarësisht zërave që pretenduan dhe të kundërtën, roli i Ashton në këtë proces ishte i rëndësishëm, ishte ajo që përcaktoi agjendën e takimeve. Strategjia e përdorur nga ana e Ashton përfshinte kombinimin e takimeve joformale me ato formale për të rritur besimin në mes palëve, përafrimin e qëndrimeve të tyre dhe më pas arritjen e marrëveshjes eventuale.<sup>39</sup> Procesi shpërfaqti elemente të 'strategjisë së manipulimit dhe formulimit' e cila u mundësua përmes nocionit të ambiguitetit kontruktiv e cila u bë e evidente edhe me synimet e ndërmjetësuesit për të "thjeshtësuar agjendën duke eliminuar, limituar apo duke kombinuar çështje".<sup>40</sup>

Më 2014, mandati të Catherine Ashton i erdhi fundi, duke mbartur nën krahë një fitore të rëndësishme. Trashëgimia e saj në rastin e Kosovës u konsiderua si ndërtim i praktikës së ushtrimit të rolit të Përfaqësuesit të Lartë, në mes të faktorëve ndërqeveritar dhe atyre supranacional, ku Ashton arriti të luante një rol të rëndësishëm "si nxitëse e politikave dhe zbatuese e tyre" për shkak të konsensusit që mbizotëroi në Këshill dhe në FAC. I njëjti konsensus bëri të mundur që në politikën e saj si nënkryetare e Komisionit të ndërlihte agjendën e zgjerimit me atë të politikës

së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së.<sup>41</sup> Duke nxitur një rol të shtuar të Komisionit Evropian në këtë proces si në rastin e rekomandimit pozitiv të Komisionit Evropian ndaj Serbisë për ofrimin e statusit të shtetit kandidat për anëtarësim në BE, ashtu dhe në rastin e rekomandimit të Komisionit për hapjen e negociatave me Kosovën për MSA-në.<sup>42</sup> Në cilësinë e tij si President i Kosovës Hashim Thaçi më 17 shkurt 2017, dekoroi baroneshën Ashton, me Medaljen Presidenciale të Meritave, për kontributin e saj në dialog dhe afrimin e Kosovës me BE-në.<sup>43</sup>

SHBA-të ishin të përfshira në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, duke i dhënë mbështetje këtij procesi dhe BE-së për ndërmjetësimin e të njëjtit. Siç u theksua në deklaratën mbështetëse ndaj Rezolutës së OKB-së, "është koha që rajoni të ec përpara dhe që Kosova dhe Serbia të ecin përpara drejtë marrëdhënieve të reja dhe të ardhmes drejtë BE-së".<sup>44</sup> Në fillimet e tij, Philip Reeker, Zëvendës sekretar i Shtetit për çështje Europiane dhe të Euroazisë, ishte drejtpërdrejt i përfshirë duke realizuar takime me përfaqësues të të dyja palëve dhe duke i shtyr palët drejtë gjetjes së zgjidhjeve të përbashkëta. Ndonëse me kalimin e kohës, përfshirja e SHBA-ve kaloi në prapaskenë të procesit, roli i tyre dhe mbështetja e që iu dha procesit mbeti tejet i rëndësishëm.

38 Bergmann, J. (2020). *The European Union as International Mediator Brokering Stability and Peace in the Neighbourhood*. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 133.

39 Po aty, Fq. 132 et al.

40 Po aty, Fq. 63-64 et al.

41 Viceré, A. G. M. (2016). The roles of the President of the European Council and the High Representative in leading EU foreign policy on Kosovo. *Journal of European Integration*, 38:5. Fq. 566.

42 Po aty, Fq. 563-565.

43 Për më shumë, shih: Presidenti Thaçi dekoron baroneshën Ashton për kontributin e saj në dialog dhe afrimin me BE-në, E qasshme në: <https://bit.ly/2CgIVjt>

44 Phillips, D. Implementation Review of the Kosovo-Serbia Dialogue. New York: Columbia University's Institute for the study of human rights. Fq. 15, E qasshme në: <https://www.helsinki.org/rs/doc/Implementation%20Review%20of%20the%20Kosovo%20-%20Serbia%20Dialogue.pdf>

# Limitet e metodës së ndërmjetësimit të Ashton si Përfaqësuese e Lartë e BE-së

Limitet e qasjes së BE-së, që solli një numër të marrëveshjeve teknike dhe Marrëveshjen e Prillit, u dëshmuar në mandatin e Përfaqësueses së Lartë të ardhshme e cila trashëgoi rolin e ndërmjetësueses së këtij procesi. Siç deklaroi dhe Cooper rruga drejtë normalizimit ishte nëpërmjet 'metodës Evropiane' bazuar në filozofinë e Komunitetit të Çelikut dhe Qymyrit, ku me anë të diskutimit të çështjeve teknike synohej ndërtimi i besimit dhe kalimi gradual drejt çështjeve më të ndjeshme të procesit. Në vetë raportin e Komisionit Evropian të vitit 2012, dërguar Parlamentit dhe Këshillit, evidentohej që Përfaqësuesja e Lartë e BE-së e kishte bërë të qartë që *"ky ishte një proces që do të ndërtohej hap pas hapi duke filluar nga çështjet më të lehta drejtë atyre të më vështirave dhe nuk do të ishte pa përfundim (open-ended)"*<sup>45</sup> ku ndër të tjera thuhej gjithashtu që *"synohej normalizimi gradual i marrëdhënieve në mes të dy palëve, pa paragjykuar pozicionin e tyre ndaj statusit të Kosovës"*.<sup>46</sup> Se cili ishte pozicioni i shteteve anëtare rreth këtij procesi nuk ishte artikuluar asnjëherë zyrtarisht nga ana e Këshillit, institucionit përgjegjës për të marrë këto lloj vendimesh në emër të BE-së. Njësoj, nuk u definua asnjëherë se çfarë nënkuptohej me normalizim të raporteve duke e bërë në fakt këtë proces të hapur (open-ended) dhe vetë normalizimin e raporteve nën këtë prizëm të limituar. Në periudhën dhjetor 2009 deri më dhjetor 2013, në 26 takimet e mbajtura në mes të liderëve të BE-së<sup>47</sup>, çështja e dialogut Kosovë-Serbi kishte qenë pjesë e këtyre diskutimeve vetëm një herë. Në konkluzat e këtij takimi thuhej: "BE ... mirëpret ri angazhimin e Serbisë në kuadër të procesit të dialogut

Beograd-Prishtinë", shprehjen e vullnetit të mirë për të zbatuar marrëveshjet e arritura, bashkëpunimin e shfaqur të Serbisë për të bërë të mundur që EULEX-i dhe KFOR-i do të mund të përmbushin mandatet e tyre në Kosovë, si pjesë e vlerësimit të ofrimit të statusit të vendit kandidatë për Serbinë.<sup>48</sup> Por çështja e statusit të Kosovës nuk ishte pjesë e këtyre konkluzave.

Nga ana tjetër, premtimi për progresin e palëve drejtë BE-së nën tutelën e së cilës zhvillohet ky proces arriti të përkthehej në një shtysë ndaj palëve për të arritur kompromis, por që gradualisht filloi të zbehë fuqinë e saj. Rrugëtimi evropian i Kosovës mbeti i paqartë. I njëjti nuk arriti të adresohet në tërësi as me pikën e fundit të Marrëveshjes së Prillit ku nga palët pritej të mos pengonin rrugëtimet individuale respektive drejt BE-së. Pavarësisht se rezonoi si mesazh shpresëdhënës, kjo klauzolë nuk e mveshi Serbinë me obligimin për të kërkuar heqjen e barrierave për Kosovën për rrugëtimin e saj evropian. Poashtu dhe BE-ja nuk ndërmori ndonjë angazhim në këtë drejtim, duke ia lënë përgjegjësinë Kosovës për të zgjidhur këtë çështje në mënyrë bilaterale me pesë shtetet mosnjohëse.<sup>49</sup> Kjo u bë e evidente edhe në nënshkrimin e MSA-së në 2016, e cila ishte marrëveshje vetëm me BE, në të cilën thuhej shprehimisht që e njëjta nuk paragjykonte qëndrimin e kësaj të fundit ndaj statusit të Kosovës, duke mos i ofruar perspektivë të qartë për anëtarësim të Kosovës në BE ndryshe nga përmbajtja e MSA-së të cilën e kishte nënshkruar Serbia.<sup>50</sup> Nga ana tjetër, liberalizimi i vizave u kthye në një mit duke vënë në pah vështirësitë në strukturën vendimmarrëse të BE-së dhe prioritizimin e politikave të brendshme nga shtetet anëtare.

45 Për më shumë, shih: Joint Report of the European Parliament and the Council on Kosovo's\* progress in addressing issues set out in the Council Conclusions of December 2012 in view of a possible decision on the opening of negotiations on the Stabilisation and Association Agreement. E qasshme në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52013JC0008&from=en>

46 Ibid.

47 Viceré, A. G. M. (2018). *The High Representative and EU Foreign Policy Integration – A Comparative Study of Kosovo and Ukraine*. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 149.

48 Konkluzionet e Këshillit të Evropës, të datës 9 dhjetor 2011. Të qasshme në: [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/DOC\\_11\\_8](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/DOC_11_8)

49 Doli D. (2019). *Brussels Agreement: Between Statehood and 1244 Status. Në: The International Element, Statehood and Democratic Nation-building*. Cham, Springer. Fq. 174.

50 Bergmann, J. (2020). *The European Union as International Mediator Brokering Stability and Peace in the Neighbourhood*. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 130

## Nga sukcesi drejt kritikave: Përfaqësuesja e lartë znj. Mogherini

Viti 2014 ishte vit zgjedhor si në Kosovë, në Serbi ashtu edhe në vet BE-në. Përfaqësuesja e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri u emërua ish-Ministrja e Jashtme e Italisë, Federica Mogherini. Emërim i cili nuk kaloi pa u kritikuar për shkak të mungesës së eksperiencës së saj të gjatë në diplomaci duke konsideruar që kishte shërbyer në këtë post vetëm për një periudhë disa mujore, u konsiderua se do mund të ndikonte dhe në vet performancën e pozitës së 'Ministrit të Jashtëm' të BE-së.<sup>51</sup> Por nga një këndvështrim tjetër, mungesa e qëndrimeve apo pozicionimit të saj paraprak lidhur me tema të caktuara u pa dhe si aset në politikën e jashtme konsensuale të BE-së. Ky i fundit qëllim edhe i vet Mogherinit, e cila në elaboratin e saj para Parlamentit Evropian deklaroi se synim i saj primar në pesë vitet e ardhshme ishte: "[...] *formësimi i politikave, vizionit dhe strategjisë së përbashkët*" të BE-së.<sup>52</sup> Në këtë prezantim të Përfaqësueses së Lartë, Ballkani u përmend së bashku me Turqinë në kuadër të politikës së zgjerimit. Sidoqoftë, pritshmëritë e përgjithshme ndaj Mogherinit shpërfaqën konfidencë që ajo do mund të zgjidhte çështjet e mbetura në mes palëve në kuadër të procesit të dialogut Kosovë-Serbi, pritshmëri të cilat në fund nuk arritën të materializoheshin.

Më 9 shkurt 2015, pas 10 muaj pauze, u mbajt takimi i parë i kryeministrave të dy shteteve nën ndërmjetësimin e Përfaqësueses së Lartë. Fokusi i paralajmëruar i këtij takimi ishte progresi i bërë dhe rruga përpara drejt normalizimit.<sup>53</sup> Palët arritën të dakordoheshin fillimisht për marrëveshjen e drejtësisë, ndërsa në gusht të po atij viti të dakordoheshin për një paketë prej katër marrëveshjeve, që do të mundësonin zbatimin e Marrëveshjes së Prillit. Ndryshe nga çfarë kishte ndodhur në të kaluarën, tani EEAS-ja publikoi këto marrëveshje<sup>54</sup>, ndërsa Mogherini deklaroi se marrëveshjet e arritura përfaqësonin hapa të rëndësishëm në procesin e normalizimit.

Gjithsesi 'shkëlqimi' i diplomacisë së BE-së i arritur në kohën e udhëheqjes së Baroneshës Ashton filloi të zbehej pavarësisht tentativave të bëra gjatë vitit 2015. Raportet në mes palëve në vazhdimësi mbeten të acaruar nën vorbullën e një sërë incidentesh e ngjarjesh të cilat vazhduan përgjatë gjithë mandatit të Mogherinit, duke ndikuar dhe në vet proces të dialogut.<sup>55</sup> Në anën tjetër vet ngecjet në proces, moszbatimi i marrëveshjeve, mungesa e transparencës, përfshirë dhe kritikën e brendshme ndaj tij veçanërisht në Kosovë që kulmuan me protesta masive kundër Parimeve të Asociacionit të

51 Shapiro, J. & Alcaro, R. (2014). Article – "High Representative, High Expectations: What to Expect from the EU's New Foreign Policy Chief". I qasshëm në: <https://www.foreignaffairs.com/articles/western-europe/2014-09-04/high-representative-high-expectations?fbclid=IwAR2ytNE50ArK5mOly-Jzicn5ABULw7O9wET1zviFMIUJkzeAKxO1Z6zdpRE8>

52 Fjala hyrëse e Federica Mogherinit në sesionin dëgjues në Parlamentin Evropian, e datës 7 tetor 2014. E qasshme në: <https://europa.ba/?p=11581>

53 Deklarata nga EEAS, e qasshme në: [https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/5987/high-level-dialogue-between-belgrade-and-pristina-resuming-9-february\\_en](https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/5987/high-level-dialogue-between-belgrade-and-pristina-resuming-9-february_en)

54 Por jo dhe planin e zbatimit të marrëveshjes së drejtësisë e cila është ende jo publike.

55 Ndër të tjera fushata ndërkombëtare e Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, fushata e çnjohjeve, ndërtimi i murit ndarës në anën e Mitrovicës së Veriut, treni i nisur nga Serbia drejt Kosovës me mbishkrimin Kosova është Serbi, vrasja e politikanit serb Oliver Ivanović, arrestimi i Marko Gjuriq në Kosovë, si dhe vendosja e taksës prej 100% ndaj produkteve të Serbisë. Këto ishin vetëm disa nga zhvillimet politike brenda dhe në mes dy shteteve që ndikuan drejtpërdrejt në proces të dialogut.



Ky i fundit qëllim edhe i vet **Mogherinit**, e cila në laboratin e saj para **Parlamentit Evropian** deklaroi se synim i saj primar në pesë vitet e ardhshme ishte: “[...] formësimi i politikave, vizionit dhe strategjisë së përbashkët” të **BE-së**.

komunave me shumicë serbe<sup>56</sup>, vunë në pah limitet e qasjes inkrementale, në mungesë të vullnetit politik të palëve dhe në mungesë të një force shtytëse të BE-së për t'i shtyr palët drejtë zbatimit të marrëveshjeve.

Pavarësisht tentativave të BE-së për ti vënë theksin efekteve që marrëveshjet kishin sjell në terren, procesi dukej sikur po shkonte drejtë qasjes ‘tërhiqe por mos e këput’. Por dhe vuri në pah gatishmërinë e palëve për të shkuar drejtë një zgjidhjeje më afatgjate dhe marrëveshjeje gjithpërfshirëse. Siç argumentuar dhe James Hooper, ish zyrtar i Departamentit të Shtetit Amerikan, që forma e marrëveshjeve të pjesshme nuk po arrinte të përmbushte qëllimet e saj dhe se kjo qasje tashmë duhej ndryshuar.

Kjo ndikoi që në korrik të vitit 2017, të filloi faza e tretë e dialogut e cila u etiketua si faza përfundimtare e këtij procesi në kuadër të së cilës pritej të arrihej një marrëveshje përfundimtare gjithpërfshirëse dhe ligjërishme e obligueshme. Paralajmërimi i këtij procesi u bë në një takim jo formal të Presidentëve të të dy vendeve, ku EEAS-ja përveç se njoftoi gatishmërinë e tyre për kalimin tashmë në këtë fazë, nuk ofroi asnjë element shtesë se çfarë përfaqësonte e njëjta dhe çfarë pritej nga palët në këtë proces.

Siç argumentojnë Bajrami dhe Weber, qasja e re mund të shihej si “*pranim implicit se dialogu i mëparshëm duke përdorur të ashtuquajturin “qasje*

*inkrementale” kishte dështuar*”<sup>57</sup>, duke vënë në pikëpyetje metodën e përdorur nga BE-ja për të arritur normalizimin e marrëdhënieve. Nga ana tjetër, fakti që BE-ja nuk kishte bërë publik kornizën negociuese dhe vijat e kuqe, shtoi paqartësinë rreth “motiveve për tu hedhur drejtë pikës së fundit të këtij dialogu”, apo dhe vet objektivave përfundimtare të tij.<sup>58</sup> Tashmë artikulli që nga palët pritej të arrihej një marrëveshje gjithpërfshirëse ligjërishme e obligueshme u bë pjesë e zhargonit rreth dialogut. Ndërsa fakti që pavarësisht ngecjeve të procesit, nën ndërmjetësimin e Mogherinit po synohej përmbyllja e këtij procesi dëshmoi gjithsesi përkushtim për ta shty procesin përpara. Përkushtim i cili dëshmoi që marrëveshja përfundimtare shkon përtej fuqisë vendimmarrëse dhe shtytëse të Përfaqësuesit të Lartë të BE-së.

Se procesi nuk do të adresonte mangësitë e tij, që përshkruan fazat e mëhershme të cekura më lartë, dhe se do të vazhdonte centralizimi i tij nën ndërmjetësimin e Mogherinit, u nënkuptua nga Komisionari i Zgjerimit Hahn i cili deklaroi se struktura e dialogut nuk do të ndryshonte për të evituar komplikimin e këtij procesi. Ai kishte nënvizuar përkushtimin e Mogherinit për të përshpejtuar procesin, ndërsa kishte njohur si pozitiv ngritjen e dialogut në nivel të Presidentëve.<sup>59</sup>

56 Presidentja e atëhershme e Kosovës znj. Atifete Jahjaga dërgoi Parimet e Përgjithshme të Asociacionit/Bashkësisë e Komunave me shumicë serbe në Kosovë, në Gjykatën Kushtetuese e cila në aktgjykimin e saj vlerësoi që Parimet nuk janë në harmoni me Kushtetutën në 23 pika të saj. Për më shumë shih: [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/ven-dimet/gjk\\_ko\\_130\\_15\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/ven-dimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf)

57 Weber, B. & Bajrami, A. (2018). *Policy Note Paper Series – The Original Framework of the Political Dialogue*. Democratization Policy Council, Kosovo Foundation for Open Society & Group for Legal and Political Studies: Berlin-Prishtina. Fq. 1

58 Po aty.

59 Për më shumë, shih lajmin: <https://europeanwesternbalkans.com/2017/09/15/hahn-structure-belgrade-pristina-dialogue-will-not-change/>

Edhe pse procesi vazhdoi të mbetet i mbyllur, me mungesë të theksuar të transparencës, Presidentët u përfshinë në komunikimet e tyre me qytetarët në formate të ndryshme, për të marrë 'aprovimin' për marrëveshjen potenciale. Vuçiq filloi një dialog të brendshëm nga i cili do të dilte skenari i pranuar për zgjidhjen me Kosovën, i cili formalisht asnjëherë nuk u përmbyll dhe nuk prodhoi një dokument publik. Në anën tjetër, Thaçi kërkoi formimin e një ekipi të unitetit ndërsa bëri publik nocionin e 'korrigjimit të kufijve' si rrugën drejt arritjes së marrëveshjes në mes palëve. Terminologjia e kësaj periudhe e cila u dëgjua në dy anët e kufirit ishte nevoja për një kompromis të dhimbshëm duke theksuar se procesi do të ishte i vështirë, por se në përfundim të tij të dyja palët do të ishin fituese – *win-win situation*.

Entuziazmi i përfaqësuesve të BE-së, përfshirë dhe të Komisionarin për Zgjerim, Johan Hahn nën Presidencën Austriake të Këshillit në kuadër të Forumit Albach, dërgoi mesazhe konfidence nga e cila shprehja "nuk jemi djem problematik" a artikulluar nga Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi krijoi përshtypjen që palët ishin më afër se kurrë një kompromisi të përbashkët. Por, në fakt, kjo ishte vetëm një copëz e një tabloje më të madhe të marrëdhënieve të ndërlikuara të palëve ndër vite, veçanërisht në kuadër të një procesi ku Përfaqësuesja e Lartë e BE-së nuk kishte arritur të siguronte mbështetjen e plotë të shteteve anëtare për ta çuar përpara zgjidhjen e propozuar e cila në përbërje të saj kishte tezën e 'korrigjimit të kufinjve'. Në diskutimet e nivelit teknik procesi filloi të cilësohej si klinikisht i vdekur edhe nga vet palët e përfshira në të.<sup>60</sup> Ndërsa shumë shpejt, edhe procesi i nivelit më të lartë filloi të konsiderohej edhe i rrezikshëm për pasojat që marrëveshje mbi bazën e korrigjimit të kufijve mund të sillte në precedentin që mund të krijonte për shtetet e tjera të rajonit dhe më gjerë.

Duket që turi i Presidentit Thaçi në shtetet e rajonit në të cilin ai embarkoi për ti siguruar liderët e këtyre shteteve që korrigjimi i kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk do të sillte efekte domino,<sup>61</sup> nuk arriti të gjente mbështetjen e Gjermanisë, e cila doli hapur kundër këtij opsioni. Njëjtë, Thaçi nuk arriti të merrte as mbështetjen e spektrit të brendshëm politik të Kosovës, e cila dëshmoi dyzimin e politikës së brendshme të vendit. Në shtator të vitit 2018, u mbajt takimi i fundit i nivelit të lartë në Bruksel, i organizuar nën ndërmjetësimin e Përfaqësueses së Lartë, nën hijen e kundërshtimit të Vuçiq për t'u takuar me Thaçin, kjo për shkak se kërkesa e tij për të vizituar Kosovën ishte refuzuar nga Ministria e Jashtme e Kosovës, për tu pranuar më vonë.

60 Për më shumë, shih lajmin: [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2018&mm=08&dd=1&nav\\_id=104856](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2018&mm=08&dd=1&nav_id=104856)

61 Për më shumë, shih editorialin e Presidentit Hashim Thaçi lidhur me korrigjimin paqësor të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë, i datës 17 shtator, 2018. I qasshëm në: <https://president-ksgov.net/en/oped/peaceful-border-correction-between-kosovo-and-serbia>



# Trashëgimia e Mogherinit

Shapiro argumenton se në rastet kur nuk ka një dakordim të shteteve anëtare të BE-së për kursin e veprimeve të përbashkëta, është përgjegjësi e Përfaqësueses së Lartë të *"synoj ndërtimin e një kursi politik i cili është i pranueshëm për shtetet anëtare dhe më pas t'i japë peshën politike të të gjithë BE-së"*.<sup>62</sup> Mënyra e ndërmjetësimit të këtij procesi nga Mogherini u duk që nuk arriti të përmbush këtë përgjegjësi kur pjesë e diskutimeve rreth marrëveshjes finale ishte dhe çështja e korigjimit të kufinjve, për të cilën nuk arriti të siguronte mbështetjen e vet shteteve anëtare të BE-së, veçanërisht të Gjermanisë. Mogherini përtej përprjekjeve të saj, nuk arriti të shtynte procesin përpara. Mbatja e këtij procesi brenda rrethit të ngushtë të Përfaqësueses së Lartë dhe ekipit të saj, u konsiderua si metodë për të anashkaluar diferencat e qëndrimeve të shteteve anëtare, që mund të kishte funksionuar në të kaluarësi dhe nevojë për hapësirën e manovrimit të vet BE-së për ti shtyrë palët drejt marrëveshjeve, nuk sollti rezultatet e pritura. Gjithsesi, mandati i Mogherinit dëshmoi se uniteti i shteteve anëtare dhe mbështetja e tyre për Përfaqësuesen e Lartë që përshkroi fazat e para të dialogut mungoi dhe në fazën finale të tij duke nxjerrë në pah përçarjen brenda shteteve të BE-së rreth këtij procesi, përçarje kjo që gjatë kësaj periudhe filloi të marrë edhe karakter transatlantik.

Qëndrimi i shtetit të Spanjës kundër shtetit të Kosovës u intensifikua pavarësisht se BE-ja po lehtësonte një proces të normalizimit në mes palëve e cila u bë e evidente në disa raste, përfshirë dhe vet ndikimin që ky shtet kishte në (mos)ofrimin perspektivës evropiane për Kosovën në Strategjinë e Zgjerimit të Komisionit, të publikuar në shkurt të vitit 2019. Ndërsa, për Gjermaninë, shteti i cili që në fillim e tij mbështeti procesin e dialogut, epilogu i procesit

dhe i vet anëtarësimit të Serbisë në BE ishte njohja e shtetit të Kosovës.

Navigimi i rolit të Përfaqësuesit të Lartë, në mes të faktorëve ndërqeveritar dhe atyre supranacional, nuk u arrit të përmbushet në plotëni nga ana e Mogherinit edhe në mungesë të 'karrotave' që Përfaqësuesja e Lartë pati në dispozicion, veçanërisht ndaj Kosovës. Premtimeve të saja për liberalizim të vizave, pas votimit të marrëveshjes së demarkimit të kufirit me Malin e Zi në Kuvendin e Kosovës, nuk i qëndruan prapa shtetet anëtare të BE-së. Ndërsa, pretendimi që, i takonte palëve të vendosnin për zgjidhjen e pranuar në mes tyre<sup>63</sup>, nuk u kthye në pozicionin e përbashkët të BE-së, duke e dobësuar dhe më tej rolin e Përfaqësuesit të Lartë në fushën e politikës së jashtme dhe duke vënë në pah supremacinë e vendimmarrjes të shteteve brenda BE-së.

Në adresimin e Mogherinit në Këshill të Sigurimit të OKB-së, duke folur për kontributin e BE-së në kuadër të sistemit multilateral, ishte shprehur se procesi i dialogut nuk i përkiste BE-së, apo të tjerëve por vetë palëve, dhe i takonte atyre që të gjenin një zgjidhje të pranueshme dhe të përshtatshme për ta. Por në realitet, kjo formulë nuk u mbështet nga Berlioni zyrtar e cila kundërshtoi fuqishëm çfarëdo diskutimi që mund të përfshinte riaranzhimet territoriale. Në po këtë adresim, ajo kishte theksuar që marrëveshja duhet të ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe duhet të kishte mbështetjen e Këshillit të Sigurimit.<sup>64</sup>

62 Shapiro, J. & Alcaro, R. (2014). Article - "High Representative, High Expectations: What to Expect from the EU's New Foreign Policy Chief". I qasshëm në: <https://www.foreignaffairs.com/articles/western-europe/2014-09-04/high-representative-high-expectations?fbclid=IwAR2ytNE50ArK5mOlyJzicn5ABULw7O9wET1zviFMIUJkzeAKxO1Z6zdpRE8>

63 Ky frazim është ende pjesë e diskutit të Përfaqësuesit aktual të Lartë të BE-së, z. Joseph Borrell.

64 Për më shumë, shih fjalimin e Përfaqësueses së Lartë të BE-së në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i datës 12 mars 2019. I qasshëm në: [https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/59506/speech-high-representativevice-president-federica-mogherini-united-nations%E2%80%99-security-council\\_en](https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/59506/speech-high-representativevice-president-federica-mogherini-united-nations%E2%80%99-security-council_en)



**Shapiro** argumenton se në rastet kur nuk ka një dakordim të shteteve anëtare të **BE-së** për kursin e veprimeve të përbashkëta, është përgjegjësi e Përfaqësueses së Lartë të “synoj ndërtimin e një kursi politik i cili është i pranueshëm për shtetet anëtare dhe më pas t’i japë peshën politike të të gjithë **BE-së**”

Bartja e paqartësive të procesit të kaluar në atë aktual, centralizimi i bisedimeve tërësisht nga ana e dy Presidentëve nën ndërmjetësimin e Mogherinit nga njëra anë, mungesa e transparencës edhe ndaj shteteve anëtare të BE-së nga ana tjetër, ndikuan në raportet e Përfaqësueses së Lartë me përfaqësuesit politik vendor, të cilat, në rastin e Kosovës, kulmuan me kërkesën e Kryeministrit të Kosovës të atëherëshëm Ramush Haradinaj për tërheqjen e Mogherinit nga ky proces, por edhe me kritikën e artikuluara në drejtim të saj nga shtetet anëtare të BE-së.<sup>65</sup>

Natyra ambigue e marrëveshjeve, insistimi në ushtrimin e rolit të ndërmjetësuesit dhe mos garantimi i zbatimit të marrëveshjeve, krijoi hapësirë të manovrimit të palëve për arritje të marrëveshjeve, por që nuk u përkthye në normalizim të raporteve në mes tyre, duke e përmbyllur mandatin e Mogherinit nën hijen e fushatës ndërkombëtare të Serbisë kundër shtetit të Kosovës dhe tarifës 100% të Kosovës ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Mbi të gjitha nën rolin e shtuar të SHBA-ve në proces dhe aktivizimin e Gjermanisë dhe Francës.

65 Për më shumë, shih lajmin: [https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/kosovos-haradinaj-wants-mogherini-out-of-dialogue-with-belgrade/?fbclid=IwAR1ikPIIjRUdu-FuOUfHA\\_KVR5KNEF51mbr7BWGYTQqbXWKvCjKe3BqASS\\_84](https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/kosovos-haradinaj-wants-mogherini-out-of-dialogue-with-belgrade/?fbclid=IwAR1ikPIIjRUdu-FuOUfHA_KVR5KNEF51mbr7BWGYTQqbXWKvCjKe3BqASS_84)

# Përfaqësuesi i Lartë dhe Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm, në rol dytësor?

Tentativa për të rikthyer modelin e paqebërjes së BE-së, u rimorën sërish në vitin 2019, por tani jo në kuadër të zyrës së Përfaqësueses së Lartë, por në nivel të Gjermanisë dhe Francës, dy shtete të cilat kishin vendosur edhe themelet e Komunitetit të Thëngjillit dhe Çelikut.

Kjo dukej si një tentativë për të shpëtuar atë pak çfarë mund të kishte mbetur nga një proces i cili doli komplet nga 'binarët evropian' kur në tryezën e vullnetit të mirë – ashtu siç njihet tryeza e ndërmjetësimit – u diskutua tema e korigjimit të kufinjve e cila nuk kishte mbështetjen e shteteve të BE-së. Ky ndërmjetësim tashmë nga Gjermania dhe Franca erdhi në një kohë kur dialogu ishte ndërprerë për shkak të taksës 100% të vendosur nga Kosova ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës dhe kërkesat e tyre për heqjen e masës kishin rënë në vesh të shurdhër. Mbi të gjitha, procesi u tentua të shtyhej përpara dhe nën hijen e rivalitetit me SHBA-të, që tashmë u bënë akterë aktiv në procesin e arritjes së marrëveshjes së paqes në mes palëve me angazhimin e drejtpërdrejtë të Shtëpisë së Bardhë nëpërmjet Ambasadorit të SHBA-ve në Gjermani Richard Grenell, si i dërguar i posacëm i Presidentit Trump për këtë proces dhe Matthew Palmer si përfaqësues special për Ballkanin Perëndimor i emëruar nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Më 29 prill 2019, Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, Presidenti i Francës, Emanuel Macron, si dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, Federica Mogherini ftuan palët në një takim në Berlin për të diskutuar rreth gjetjes së zgjidhjes për rikthim në dialog, në një Samit të Ballkanit Perëndimor në kuadër të së cilit pritej të diskutoheshin edhe për aspiratat evropiane të rajonit. Organizimi i këtij Samiti nga ana e Merkel dhe Macron vuri nën hije Brukselin zyrtar dhe formatin nën të cilin ishte zhvilluar deri më tani

procesi i ndërmjetësimit.<sup>66</sup> Gjithsesi, Samiti nuk arriti të afronte palët duke vënë në pah dhe vet ndasitë e mëdha në mes të Parisit, Berlinit, shteteve anëtare të BE-së dhe aparatit të politikës së jashtme të BE-së.<sup>67</sup>

Gjermania në mënyrë të qartë ishte kundër idesë së korigjimit të kufijve duke e konsideruar atë si ide të rrezikshme, ndërsa Franca ishte treguar më e hapur ndaj saj nën artikullimin se nuk duhet të kishte imponim të temave dhe tema tabu. Përfaqësuesit politik kosovar, përkatësisht Presidenti Thaçi dhe Kryeministri i atëhershëm Haradinaj u shfaqën të përçarë në qëndrimet e tyre ndërsa në diskutime publike që pasuan këtë takim u bë me dije që kërkesa për heqjen e tarifës për një afat gjashtëmujor, në shkëmbim të vizave, kishte qenë propozim i artikuluar ndaj palës kosovare.

Në mungesë të zgjidhjes së ngërçit në të cilin ndodhej dialogu, përballë palëve të betonuara në qëndrimet e tyre, Samiti i Parisit i planifikuar të ndodhte pas atij të Berlinit u shty për një kohë të dytë. Ndërsa, Samiti i Berlinit u përmyll me një deklaratë zyrtare të përgjithshme e cila njoftonte që palët ishin dakorduar të punonin në mënyrë konstruktive për të normalizuar marrëdhëniet, por pa ndonjë rezultat konkret. Zgjedhjet për Parlamentin Evropian sollën kompozim të ri të Komisionit Evropian, i cili solli ndërmjetësues të rinj të procesit të dialogut nga ana e BE-së. Pritshmëritë ishin tashmë të qarta: duhej një qartësim i rolit të BE-së në këtë proces kundrejt atij të SHBA-ve, ndërsa skena politike e brendshme e Kosovës filloi të shihte një dyzim të rreshtimit të palëve, përkatësisht të Presidentit dhe Kryeministrit, prapa opsioneve të ofruara nga SHBA-të dhe BE-ja respektivisht.

66 Karnitschnig, M. (2019). Article – "Macron's Balkan Break-down". Politico. I qasshëm në: <https://www.politico.eu/article/merkel-macron-balkans-serbia-kosovo/>

67 Po aty.

## Mantra e vjetër nga zyrtarët e rinj “diversitet rreth njohjes, por unitet në angazhim”<sup>68</sup>

### Spanjoli Borrell Përfaqësues i Lartë i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së

Në krye të politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së, u emërua ish-Ministri i Jashtëm të Spanjës, Joseph Borrell. Emërimi i tij u prit me skepticizëm duke ditur qëndrimin jo njohës dhe kundërshtues të këtij shteti ndaj shtetit të Kosovës por dhe të vet Borell. Diplomati me origjinë katalunase, kishte kundërshtuar zëshëm shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe marrja e këtij mandati nga ana e tij që do të nënkuptonte dhe ndërmjetësimin e dialogut Kosovë-Serbi ngriti pikëpyetje të shumta rreth pozicionit që ai do të mbante në kuadër të këtij procesi.<sup>69</sup>

Në prezantimin e tij para Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, ai kishte deklaruar se shtetet anëtare të BE-së mund të sillen si të duan kundrejt shtetësisë së Kosovës, por se ai përfaqëson politikën e jashtme të BE-së e cila kornizohet në termet e nevojës së arritjes së marrëveshjes në mes palëve në kuadër të rrugëtimit evropian. Gjithsesi, ai kishte shtuar se Kosova nuk mund të sillej si shtet derisa nuk ka njohje të shteteve si India e Kina<sup>70</sup> – deklarata të cilat në publik nuk ishin artikuluar më parë nga zyrtarë të BE-së.

Emërimi i Borrell erdhi në një kohë kur tashmë Shtëpia e Bardhë kishte emëruar një të dërguar special për negociatat e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë, Ambasadorin Richard Grenell, ndërsa

Departamenti i Shtetit Amerikan, emëroi Matthew Palmer emisar për çështje të Ballkanit Perëndimor. Në një kohë kur tryeza e diskutimit për palët tashmë dukej të ishte transferuar nën Uashingtonin zyrtar, i cili kishte artikuluar qartazi dhe publikisht që epilogu i procesit duhet të jetë njohja reciproke. Se nuk i takonte BE-së të njihte Kosovën ishte qëndrim i përsëritur i Përfaqësuesit të Lartë të BE-së edhe gjatë vizitës së tij në Kosovë, dhe më tej, duke shtuar që kjo çështje i përkiste Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ndërsa, u tha se BE-ja ishte ndërmjetësues i këtij procesi, se nuk kishte një garë me SHBA-të dhe se Bashkimi Evropian nuk ishte i plotë pa Ballkanin Perëndimor. Diskutime rreth mundësisë së emërimit të një dërguari të posaçëm nga ana e Këshillit Evropian lidhur me çështjen e dialogut Kosovë-Serbi filluan të artikuloreshin shumë shpejt duke konsideruar dhe faktin që tashmë SHBA-të kishin një të tillë dhe se agjenda e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri ishte e ngjeshur.

Pas diskutimesh të shumta dhe qarkullimit të emrave potencial, ku nuk u përjashtuan as diskutimet se Përfaqësuesi special do duhet të vinte dhe nga një shtet i fuqishëm i BE-së që njeh shtetin e Kosovës për të krijuar një balancë me Borrell por dhe për të dëshmuar përkushtimin e BE-së për këtë proces, ish Ministri i Jashtëm i Sllovakisë, Miroslav Lajčak, doli të jetë kandidati i preferuar i BE-së për këtë pozitë. Por, tashmë pozicioni i BE-së në kuadër të këtij procesi nuk ishte më i njëjtë.

68 Bergmann, J. (2020). The European Union as International Mediator Brokering Stability and Peace in the Neighbourhood. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 130

69 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.evropaelire.org/a/emerimi-i-borrellit-ne-be/30034838.html>

70 Për më shumë, shih lajmin: [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2019&mm=10&dd=07&nav\\_id=107349](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2019&mm=10&dd=07&nav_id=107349)



Diskutime rreth mundësisë së emërimit të një dërguari të posaçëm nga ana e **Këshillit Evropian** lidhur me çështjen e dialogut **Kosovë-Serbi** filluan të artikuloreshin shumë shpejt duke konsideruar dhe faktin që tashmë **SHBA-të** kishin një të tillë dhe se agenda e Përfaqësuesit të Lartë të **BE-së** për Politikë të Jashtme dhe Siguri ishte e ngjeshur.

SHBA-të arritën t'i shtyjnë palët drejt nënshkrimit të një sërë marrëveshesh të qëllimit të mirë pa praninë e evropianëve në tavolinë në Berlin pavarësisht faktit që taksa ishte ende dhe të ndjekin një rrugëtim të tyre të pavarur nga BE-ja me palët në kuadër të procesit duke konfirmuar qëndrimin e ndryshme me BE-në. Kjo e fundit u bë e evidente me vendimin e marrë nga Qeveria e sapo formuar e Kosovës për heqjen e tarifës 100% dhe vendosjen e masave të reciprocitetit ndaj Serbisë. Derisa shtete anëtare të BE-së si dhe përfaqësuesit e saj mirëpritën këtë hap, SHBA-të e konsideruan të njëjtën të papranueshme duke kërkuar heqjen e të gjitha barrierave tarifore dhe jo tarifore nga ana e Qeverisë së Kosovës kundrejt Serbisë, duke ndikuar dhe në vet raportet e

SHBA-ve me Kosovën. Kjo ndikoi dhe në jetëgjatësinë e Qeverisë, e cila në kohë të përballjes me pandeminë COVID-19, vetëm 52 ditë pas formimit, përkatësisht më 25 mars, u shkarkua me mocion të mosbesimit. Në të njëjtën kohë, kredibiliteti i vendimmarrjes së përbashkët të BE-së u atakua nga Presidentët e të dy shteteve që theksuan mungesën e qëndrimit unik të shteteve të BE-së ndërsa trasimi i dy proceseve të ndara, një i ndërmjetësuar nga BE dhe tjetri nga SHBA-të, u evidentua dhe më shumë.

## Emërimi i Lajçak

Sipas Nenit 33 të Traktatit të Lisbonës në bazë të propozimit të Përfaqësuesit të Lartë, Këshilli mund të emërojë një Përfaqësues special me një mandat të veçantë për një çështje të caktuar nën autoritetin e tij/saj.<sup>71</sup> Më 3 prill të këtij viti, Këshilli njoftoi emërimin e Miroslav Lajçak si përfaqësues special i BE-së për dialogun Kosovë-Serbi dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor. Në përshkrimin e përgjithshëm të detyrave të tij, sipas Këshillit, Lajçak pritet të angazhohet në arritjen e normalizimit gjithëpërfshirës të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, përmirësimin e raporteve të fqinjësisë së mirë dhe pajtimin në mes të partnerëve në Ballkanin Perëndimor.<sup>72</sup>

Në intervistën e tij të parë si Përfaqësues special për mediat vendore në Kosovë, Lajçak nënvizoi po të njëjtat qëllime të Rezolutës së OKB-së duke theksuar që ishte nën përgjegjësinë e palëve të vendosnin për agjendën dhe afatin e përfundimit të këtij procesi, duke mos ofruar përshtypjen se qasja e BE-së do të kishte ndonjë ndryshim. Siç kishte ndodhur dhe gjatë kohës së Mogherinit, nuk kishte një dokument të ri të mbështetur nga ana e Këshillit me anë të së cilit do të përcaktohej qartazi mandati i të Përfaqësuesit Special në kuadër të procesit të dialogut, pozicioni i përbashkët i BE-së përtej nocionit të gjerë të normalizimit, parimet negociuese të këtij procesi apo vijat e kuqe të tij. Nga ana tjetër, nuk u artikuloan as veprimet të cilat BE-ja dhe shtetet e saj anëtare do të ndërmerrnin në kuadër të këtij procesi për t'i ofruar perspektivë evropiane Kosovës, duke e ditur që e njëjta nuk mund të jetë e prekshme deri në njohje nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Në një kohë që Serbisë vazhdoi me hapjen e kapitujve të rinjë të

negociatave ku deri me tani ka hapur 18 nga 35 dhe pres të hap të tjerë në vjeshtë të vitit 2020.

Emërimi i Lajçak, i cili gjatë kohës sa mbante pozitën e Ministrit të Jashtëm të Sllovakisë kishte votuar kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, u kundërshtua veçanërisht nga Presidenti i Kosovës. Ndarja brenda politikës së brendshme të Kosovës rreth rolit që BE dhe SHBA-të duhet të kenë në kuadër të këtij procesi u konfirmua dhe nga qëndrimi publik i Presidentit Thaçi, i cili deklaroi se do të refuzonte të merrte pjesë në një takim të ndërmjetësuar nga i emëruari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajçak, por jo dhe pjesëmarrjen në samite të ftuara nga Macron apo Merkel.<sup>73</sup> Kjo solli edhe reagimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së, Joseph Borrell, i cili deklaroi që dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja është i pa alternativë për rrugëtimin evropian të palëve. Kjo nuk e pengoi Lajçakun që të zhvillonte vizitën e tij në Prishtinë ku u takua me të gjithë përfaqësuesit politikë përfshirë Presidentin Thaçi. Lajçak rikonfirmoi qëndrimin neutral të BE-së duke insistuar në mandatin e BE-së të marr nga Rezoluta e OKB-së, në normalizim të marrëdhënieve duke ia lënë palëve në proces të përcaktojnë se ku duhet të arrihet me këtë proces.

Ndërsa u theksua nevoja e fokusit të përbajtja e marrëveshjes dhe jo tek shpejtësia e arritjes së saj, që mund të lexohet dhe si një kundërvënie ndaj qasjes së SHBA-ve e cila dukej se synonte arritjen e një marrëveshjeje në mes palëve në një afat më të shkurtër kohor, që ndërlidhet me zgjedhjet presidenciale që pritet të mbahen në nëntor 2020. Gjithsesi një afat kohor nuk mbeti pa u përmendur edhe nga Lajçak i cili tha që pret që marrëveshja të arrihet deri vitin e ardhshëm. Periudhë kjo që perkon dhe me mandatin e tij një vjeçar të akorduar nga Këshilli.

71 Viceré, A. G. M. (2018). The High Representative and EU Foreign Policy Integration – A Comparative Study of Kosovo and Ukraine. Cham: Palgrave Macmillan. Fq. 80.

72 Për më shumë shih komunikatën për media të Këshillit Evropian, i datës 3 prill 2020. I qasshëm në: <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2020/04/03/belgrade-pristina-dialogue-eu-appoints-a-new-special-representative/>

73 Për më shumë, shih lajmin: [https://europeanwesternbalkan.com/2020/05/27/thaci-not-willing-to-negotiate-in-a-dialogue-facilitated-by-lajcak/?fbclid=IwAR2IDSHQFAMzgRQPY-bHCl\\_svn12cmKal69FNGhfjatr1RxQyuvpbF1aCtk](https://europeanwesternbalkan.com/2020/05/27/thaci-not-willing-to-negotiate-in-a-dialogue-facilitated-by-lajcak/?fbclid=IwAR2IDSHQFAMzgRQPY-bHCl_svn12cmKal69FNGhfjatr1RxQyuvpbF1aCtk)



Ndarja brenda politikës së brendshme të **Kosovës** rreth rolit që **BE** dhe **SHBA-të** duhet të kenë në kuadër të këtij procesi u konfirmua dhe nga qëndrimi publik i **Presidentit Thaçi**, i cili deklaroi se do të refuzonte të merrte pjesë në një takim të ndërmjetësuar nga i emëruari i posaçëm i **BE-së** për dialogun **Kosovë-Serbi**, **Miroslav Lajçak**, por jo dhe pjesëmarrjen në samite të ftuara nga **Macron** apo **Merkel**.

Se mbetet tejet e rëndësishme që të ketë përcaktim të një qëndrimi të përbashkët të 27 shteteve anëtare të BE-së, u bë më se e qartë edhe në deklaratimet e bëra nga ana e Borrellit, i cili në një intervistë për gazetarët e rajonit në pyetjen rreth korigjimit të kufijve u shpreh se “nuk na takon ne t’ju themi kosovarëve dhe serbve për çfarë duhet të dakordohen. Roli ynë do të jetë lehtësimi i procesit. Po ne nuk mund të jemi më katolik se Papa. Nëse ata dakordohen për dicka ne duhet të studiojmë atë marrëveshje”.<sup>74</sup>

Kjo deklaratë në fakt solli shumë reagime nëse teza e korigjimit të kufinjve ishte ende një tezë e pranuar që solli dhe deklarin e Lajçak i cili e pa të nevojshme të sqaronte se çështja e korigjimit të kufijve nuk ishte një zgjidhje e pranueshme. Këto mesazhe krijuan përshtypjen e mungesës së një qëndrimi të unifikuar, siç u theksua në vazhdimësi nga ana e Presidentit Thaçi, i cili vuri në dyshim fuqinë vendimmarrëse të BE-së duke u shprehur se: “Bashkimi Evropian ... nuk ka as aftësi, as unitet, as fuqi, as dije e as vizion e as lidhësi për të shtyrë përpara këtë proces”.<sup>75</sup>

Një rol më aktiv i Gjermanisë dhe Francës i dëshmuar dhe gjatë periudhës së fundit të mandatit të kaluar të Përfaqësuesit të Lartë, e formuluar dhe në mbështetjen ndaj të Emëruarit Special dha sinjale pozitive. Por që këto sinjale duhet të përkthehen dhe në artikullim të qartë dhe të unifikuar të vet shteteve anëtare të BE-së kundrejt këtij procesi, i cili duhet të tejkaloj paradigmen e ambiguitetit dhe neutralitetit por që dëshmon objektivat e qartë të politikës së përbashkët të BE-së dhe vizionin e saj në raport me Ballkanin Perëndimor.

Veprime konkrete të cilat duhet të fillojnë me liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës dhe marrje të përgjegjësisë për ofrim të rrugëtimit evropian për Kosovën e cila arrihet me hapin e parë - njohjen e shtetit të Kosovës nga pesë shtetet jo njohëse. Pra shtetet anëtare duhet të shohin rolin e tyre nëpërmjet BE ashtu dhe siç mëtojnë të jetë, transformues dhe integruar për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Por kjo vështirë se arrihet pa mbështetur me qëndrime të qarta këtë vizion.

74 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.koha.net/ar-beri/220523/borrell-nuk-eshte-kunder-ndryshimit-te-kufijve-te-kosoves/>

75 Për më shumë, shih lajmin: [https://zeri.info/aktuale/330996/thaci-be-na-ndeshkoi-me-viza-nuk-ka-unitet-e-as-afte-si-per-ta-shtyre-dialogun-me-serbine/?fbclid=IwAR2pzTqN-fMbVFyHg\\_Ms3yRy\\_83bB\\_kOdyBdTdFgqDqxCU2zkuabdG-8Md0mM](https://zeri.info/aktuale/330996/thaci-be-na-ndeshkoi-me-viza-nuk-ka-unitet-e-as-afte-si-per-ta-shtyre-dialogun-me-serbine/?fbclid=IwAR2pzTqN-fMbVFyHg_Ms3yRy_83bB_kOdyBdTdFgqDqxCU2zkuabdG-8Md0mM)

## Dyzimi i rolit të BE-së dhe SHBA-ve

Se procesi i dialogut Kosovë-Serbi i ndërmjetësuar nga BE-ja kishte mbështetjen e SHBA-ve dhe sa e rëndësishme ishte kjo, u bë e qartë me vizitën e përbashkët të Ashton dhe Clinton në Prishtinë dhe Beograd në tetor të vitit 2013. Në fakt, kjo vizitë dukej si një 'dorëzim' i kësaj çështjeje nga SHBA-të tek BE-ja, e cila me anë të agjendës së saj të zgjerimit, duhej të shtynte palët drejt një normalizimi të marrëdhënieve. Mbështetja e SHBA-ve ishte shënuar dhe në raste të ngecjes në arritjen e marrëveshjeve të caktuara siç kishte qenë dhe ajo e përfaqësimit apo fusnotës, kur ishte raportuar që pas vizitës së Thaçit në SHBA, ishte arritur dakordimi për të bërë kompromis.<sup>76</sup> Ndërsa, qëndrimet e artikuluara prej administratës amerikane theksonin se çështja e kufijve ishte çështje e mbyllur. Edhe pse roli i SHBA-ve nuk ishte aq aktiv në publik, ai ishte i thelbësor dhe në arritjen e Marrëveshjes së Prillit të ndërmjetësuar nga Baronessa Ashton. Deklaratat e vazhdueshme publike në mbështetje të procesit si dhe takimet e vazhdueshme të delegacioneve të Kosovës me përfaqësuesit diplomatik të SHBA-ve dhe zyrtarët e lartë shtetëror lidhur me këtë proces, mbi të gjitha vetë roli i SHBA-ve në shpalljen e Kosovës shtet, e bën atë një aktor kyç për ta shtyr përpara këtë proces.

Një qasje më aktive e shprehur nën administratën e Presidentit Trump, e konfirmuar dhe me letrat që ky i fundit i dërgoi Presidentit të Kosovës dhe atij të Serbisë, solli rritjen e rolit të SHBA-ve. Një kohë kur roli i BE-së ishte duke u zbehur për shkak të mungesës së unitetit të brendshëm lidhur me zgjidhjen potenciale në mes palëve, nën rritjen e skepticizmit për agjendën e zgjerimit, mungesën e gatishmërisë për ofrimin të liberalizimit të vizave dhe pranë një cikli të ri zgjedhor. Gjithashtu në mungesë të forcës së Përfaqësueses së Lartë për të shtyr palët të riktheheshin në tavolinë negociuese u pa një rol i

shtuar i SHBA-ve. Së pari, me angazhimin e Matthew Palmer si i dërguar i posaçëm i Departamentit të Shtetit Amerikan dhe më pastaj me të dërguarin e posaçëm të Shtëpisë së Bardhë, Ambasadorin e SHBA-ve në Gjermani Richard Grenell.

Spektri i brendshëm i Kosovës në vazhdimësi kishte kërkuar një rol më aktiv të SHBA-ve, por tashmë dy qasje të ndara njëra nga ana e BE-së dhe tjera nën ndërmjetësimin e Ambasadorit Grenell reflektuan dhe në zhvillimet e brendshme politike në Kosovë. Por dhe në një rivalitet në mes këtyre dy partnerëve ndërkombëtarë që shtuan paqartësinë rreth vet procesin në përgjithësi. Angazhimi i Ambasadorit Grenell rezultoi në nënshkrimin e tre letrave të qëllimit të mirë në mes palëve ku fokus ishin çështjet e bashkëpunimit në fushën e ekonomisë. Nënshkrimi i këtyre letrave ndodhi në Berlin pa pjesëmarrjen e evropianeve dhe në një kohë kur taksa ishte ende në fuqi. Përçarja e spektrit të brendshëm kosovar rreth kërkesave të qarta që u artikuluan prej BE-së dhe veçanërisht SHBA-ve që kërkuan heqjen e të gjitha masave të cilat mund të konsideroheshin si barriera në rifillimin e dialogut ndikoi në rënien e dy qeverive konsektive në Kosovë. Në rradhë të parë, rënien e Qeverisë Haradinaj i cili refuzoi të hiqte apo pezullonte taksën. Më pas të Qeverisë Kurti i cili hoqi taksën por vendosi masa të reciprocitetit ndaj Serbisë. Ndonëse roli i SHBA-ve në këtë proces kërkon një analizë të zgjeruar, nevoja për qartësim të proceseve të ndërmjetësuar nga BE-ja dhe SHBA-të mbeten vitale. Por padyshim se mund të konkludohet që përfshirja më e madhe e SHBA-ve e cila që nga fillimi artikuloi qartazi dhe publikisht epilogun e pritshëm të marrëveshjes në mes palëve – njohjen reciproke, duhet të shërbej si një thirrje ndaj BE-së dhe shteteve anëtare për qartësim të pozicionit të tyre dhe marrje të përgjegjësive të shtuara në proces që shkon përtej ndërmjetësimit klasik të një procesi të bisedimeve.

76 Van der Borgh, Ch. & Le Roy, P. & Zweerink, F. (2018), "EU peacebuilding capabilities in Kosovo after 2008: an analysis of EULEX and the EU-facilitated Belgrade-Pristina Dialogue", *Center for Conflict Studies, Utrecht University*, Fq. 52



# Konkluzione

Transformimi i Ballkanit Perëndimor u synua me anë të instrumentit më efektiv që ka në dispozicion Bashkimi Evropian – instrumentin e zgjerimit. Me anë të integritimit në BE, u konsiderua se në Ballkanin Perëndimor do të mund të garantohej stabiliteti rajonal dhe mbrojtja e interesave gjeopolitike perëndimore. Në të njëjtën kohë, nuk ishin të paktën ata që besuan që me anë të përafritimit të raporteve të shteteve të rajonit me BE-në qoftë përmes rrugëtimit zyrtarë të anëtarësimit apo dhe formave të tjera përfshirë Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), reforma të nevojshme që do të garantonin shtet të së drejtës dhe sundim të ligjit do të ndërmerreshin. Ndërsa vlerat evropiane të demokracisë do të shëndrroheshin në vlera të vet këtyre shteteve.

Mendësi e ngjashme kishte mbizotëruar dhe në zgjerimin e madh (big bang) të vitit 2004 me anëtarësimin e 10 shteteve të Evropës Qendrore, të cilat dëshmuuan limitet e forcës transformuese të BE-së veçanërisht pas anëtarësimit të tyre në familjen evropiane. Kjo ndikoi dhe në zbehjen e interesimit të BE-së për të shtyr përpara agjendës e zgjerimit, siç u njoh nën termin e 'lodhjes ndaj zgjerimit' që patjetër ndikoi dhe në raportet e BE-së me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Por gjithsesi, BE mbeti e përkushtuar ndaj Ballkanit Perëndimor, ku pjesë të angazhimit të saj ishte dhe marrja përsipër e zgjidhjes së çështjeve të hapura të rajonit si pjesë e politikës së jashtme të BE duke e ndërlikuar atë me agjendën e zgjerimit siç është dhe procesi i dialogut Kosovë-Serbi. Kjo solli dhe te kritikën drejtuar qasjes së përdorur nga BE ku synimi për stabilitet u prioritetizua në kurriz të politikave të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit.<sup>77</sup>

Me anë të Rezolutës së OKB-së e cila i dha mandat BE-së të ndërmjetësoje dialogun Kosovë-Serbi duke udhëhequr palët drejtë rrugëtimit evropian dhe duke synuar përmirësimin e jetës së qytetarëve, u vu në test dhe politika e jashtme e përbashkët e Bashkimit Evropian. Ashtu siç argumentohet përgjatë këtij punimi, fazat e hershme të këtij procesi, ai i procesit teknik dhe më pas politik të cilat u zhvilluan nën mbikqyrjen apo drejtpërdrejt nga Përfaqësuesja e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri Baronessa Catherine Ashton, përtej limiteve të tyre arritën të sjellin rezultate. Marrëveshjet e arritura u konsideruan si hapa të rëndësishëm drejtë zgjidhjes së problemeve në mes palëve, në një kohë kur dhe vet Ashton arriti të mobilizoj mbështetjen e shteteve anëtare rreth këtij procesi. Por se kjo qasje kishte limitet e saja dhe nuk mund të pritej të sillte të njëjtat rezultate apo dhe rezultate të qëndrueshme në fazat e mëtejme u bë evidente gjatë mandatit të Përfaqësueses së Lartë të rradhës Federica Mogherini.

Secila prej rreth 33 marrëveshjeve të arritura në thelb të tyre bartin ambiguitetin konstruktiv – metodë që i lejoj Kosovës dhe Serbisë të mbanin qëndrimet e tyre të kundërta rreth shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe palët të riktheheshin në tryezën e diskutimit. Në të njëjtën kohë, i ofroi BE-së, në rastin specifik Përfaqësuesit të Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, hapësirë të manovrimit dhe ruajtjen e qëndrimit neutral ndaj Kosovës duke konsideruar që vet BE ka qëndrim të ndarë si pasojë e mosnjohjes së Kosovës nga 5 shtete anëtare të saj. Nacion ky që la pa përgjigje tash e sa kohë pyetjen, çfarë do të thotë normalizim i marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë?

Kjo metodë e bërë bashkë me 'qasjen inkrementale' të marrëveshjeve, ku nëpërmjet arritjes së marrëveshjeve në tema të caktuara u synua dhe normalizimi i marrëdhënieve në mes palëve, vuri në pah dhe limitet e vet metodës së zbatuar në këtë proces. Për më tepër, edhe element i tretë

77 Florian Bieber e quajti këtë nocion stabilitokrasi, për më shumë shih: <https://biepag.eu/what-is-a-stabilitocracy/>

i këtij procesi, ai i mbylljes së tij vetëm në nivel të elitave dhe me kalimin e kohës dhe në vetëm rrethin e ngushtë të zyrës së Përfaqësuesit të Lartë, dëshmoi kompleksitetin e këtij procesi dhe nevojën e mbështetjes së tij nga shtetet anëtare nëpërmjet një vizioni të qartë dhe qëndrimi të përbashkët përtej rrëfimit të neutralitetit.

Duket që kërkesës së Henry Kissinger se kur dëshiron të flasësh me Bashkimin Evropian kë duhet të thërrasësh mund të thuhet që ende nuk i është dhënë përgjigja e plotë. Në një kohë kur Këshilli Evropian është autoriteti më i lartë për vendimmarrjen kolektive të shteteve anëtare të BE-së, i cili synon vendimmarrjen nëpërmjet koordinimit të politikave konsensuale dhe integrimin ndërqeveritar. Politika këto që mund të artikulohen dhe shtyhen përpara nga Përfaqësuesi/ja e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri në emër të BE-së vetëm atëherë kur shtetet anëtare kanë dakordim.

Duke operuar në kuadër të arkitekturës komplekse të politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, dhe në momente të caktura duke synuar dhe neglizhimin e limiteve të saj, Përfaqësuesja e Lartë Federica Mogherini tentoi të shtyj procesin drejtë përmblylljes së tij duke hequr dorë nga 'qasja inkrementale'. Nën paqartësinë e synimit të procesit, në rrethin e ngushtë të zyrës së saj dhe të dy Presidentëve Thaçi dhe Vuçiq, tema siç ishte ajo e 'korrigjimit të kufinjve' u bënë pjesë e diskutimit të cilat u kundërshtuan fuqishëm nga shtete anëtare të BE-së siç ishte Gjermania dhe nga vet spektri i brendshëm politik në Kosovë.

Trashëgimia e Mogherinit në kuadër të këtij procesi u konsiderua si e zbehtë<sup>78</sup>, por që solli një mësim të rëndësishëm. Një marrëveshje e llojit gjithpërfshirës në kuadër të së cilës duhet të arrihet njohja reciproke në mes palëve, zhbllokimi i perspektivës evropiane të Kosovës me njohjen nga pesë shtetet jo njohëse, është një objektivi që tejkalon kompetencat dhe fuqinë vepruese të Përfaqësuesit të Lartë apo dhe në rastin konkret të një të dërguarit të Posaçëm. Mandati

i Mogherinit riafirmoi nevojën e mbështetjes së qartë të procesit nga shtetet anëtare të këtij procesi i cili në vetvete nuk përmban vetëm projektin e fuqisë së 'butë' të BE-së në politikën e jashtme por duke e ndërlidhur atë me agjendën e zgjerimit kërkon tejkalim të neutralitetit dhe artikullimit të qëndrimit të përbashkët.

Gjatë mandatit të Mogherinit u shënuan dhe përfshirja direkte e dy shteteve anëtare përkatësisht Gjermanisë dhe Francës të cilat synuan të marrin nën ombrellën e tyre këtë proces me organizimin e Samiteve në kryeqendrat e tyre. Njëri u mbajt pa rezultatet e pritura ndërsa tjetri pritet të organizohet shpejt. Shtysë e së cilit ishte nga një anë diskutimi i çështjes së 'korrigjimit të kufinjve' nën ndërmjetësimin e Mogherinit, por dhe nga ana tjetër roli i shtuar i SHBA-ve në ndërmjetësimin e procesit që u duk sikur la në hije vet BE-në.

Mbështetja e vazhdueshme e SHBA-ve në kuadër të procesit, kishte qenë kyçe që nga fillimet e procesit. Por 'çarja' transatlantike lidhur me zgjedhjen potenciale në mes palëve dhe rolin e tyre në procesi, solli një sërë paqartësisht dhe në një dyzim të vet procesit. Kjo solli deri te nevoja për qartësim të rolit që SHBA ka dhe do vazhdojnë të ketë në kuadër të këtij procesi dhe rolin e vet BE - i cili në vetvete është i ndarë në atë të shteteve anëtare të tij dhe të Përfaqësuesit të Lartë dhe të Emëruarit Special Lajçak.

Në anën tjetër, raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë në vazhdimësi mbeten të acaruar nën vorbullën e një sërë incidentesh e ngjarjesh. Ndërsa vet zhvillimet politike brenda Kosovës të cilat kulmuan dhe së fundmi me publikimin e propozim aktakuzës nga Dhoma e Specializuar për Presidentin e Kosovës Hashim Thaçi dhe kryetarin e partisë demokratike të Kosovës Kadri Veseli për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, dhe zhvillime të tjera mund të pritët të kenë ndikim dhe në vet proces të dialogut.

78 Për më shumë shih: <https://dgap.org/en/research/publications/mogherinis-legacy>

# Rekomandime

---

- Presidenca Gjermane e Këshillit të BE-së duhet të adresoj çështjen e liberalizimit të vizave duke e përshirë atë si pjesë të agjendës së këtij mandati dhe duke i bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për t'ju ofruar qytetarëve të Kosovës mundësinë për lëvizje të lirë. Kjo për të dëshmuar vullnetin e mirë të BE-së në përmbushjen e premtimit të dhënë ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj.
- Nën të njëjtën frymë, Bashkimi Evropian duhet të përcaktoj rolin e saj në kuadër të procesit të dialogut Kosovë-Serbi në instancën e saj më të lartë vendimarrëse ndërqeveritare, Këshillin Evropian që duhet të shkoj përtej rolit neutral të lehtësuesit të procesit. Nga njëra anë, duke e mvëshur Përfaqësuesin e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe të Dërguarin e Posaçëm me përgjegjësitë e nevojshme për ta shtyrë këtë proces përtej çështjeve teknike. Nga ana tjetër, duke shprehur përkushtimin e shteteve anëtare të BE-së për të mbështetur një proces të normalizimit i cili ka synim të qartë dhe të mirëdefinuar – shtyrjen e palëve drejtë njohjes reciproke dhe perspektivës evropiane. Kjo si ndërlidhje e drejtpërdrejt e politikës së përbashkët të jashtme dhe agjendës së zgjerimit.
- Shtetet anëtare të BE-së duhet të marrin përsipër ofrimin e perspektivës së qartë evropiane të Kosovës duke garantuar njohjen nga pesë shtetet jo njohëse dhe duke shtyr procesin e konsolidimit ndërkombëtar të Kosovës në arenën ndërkombëtar, me anëtarësimin e saj në OKB.
- Duhet të ketë qartësim të procesve të ndërmjetësuar nga Brukseli zyrtar dhe roli i shteteve anëtare në këtë rast të Gjermanisë dhe Francës, mbështetja e të cilëve duhet të jetë prezente përgjatë gjithë procesit.
- BE duhet të synoj bashkërendimin me SHBA-të në kuadër të këtij procesi, si aleat i cili ka mbështetur dialogun që në instancat e para të tij.
- Diskutimet rreth fazës finale të dialogut duhet të evitohen në mënyrë strikte përfshirjen e nocioneve ambigüe apo dhe vet qasjes së njohur tashmë si ambiguiteti konstruktiv. Marrëveshja duhet të jetë e qartë në terminologjinë e përdorur duke përcaktuar qartësisht obligimet e palëve, afatet kohore të zbatimit, si dhe garancat e ofruara nga ana e BE-së për zbatimin e marrëveshjeve. Progresi i rrugëtimit evropian të palëve duhet të ndërlidhet me zbatimin e marrëveshjeve, palët moszbatuese duhet të ndëshkohen.
- Procesi duhet të jetë transparent ndaj qytetarëve të të dyja palëve duke synuar normalizimin e marrëdhënieve jo vetëm nëpërmjet qasjes 'lartë-poshtë' në nivel të elitave por dhe atë 'poshtë-lartë' në nivel të qytetarëve.



Kosova Democratic Institute  
Bajram Kelmendi N/45  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel/Fax: +381(0)38 248 038  
[info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)



Konrad-Adenauer-Stiftung  
Bulevardi Nënë Tereza, 27/3-6  
10000 Prishtinë  
Tel: +383(0)38 229 874  
[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)